



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 33, datë 28.12.2021

**PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË Z. ALBERT DEMIRNELI
NË VENDET VAKANTE PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, TË
SHPALLURA NGA GJYKATA E LARTË NË DATAT 22.11.2018, DATË 19.04.2019 DHE
RISHPALLUR NË DATË 03.06.2021**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

| | |
|---------------------|--------------------|
| Ervin Pupe | Kryetar |
| Marsida Xheferllari | Zëvendëskryetare, |
| Elsa Toska | Anëtare |
| Adnan Xholi | Anëtar |
| Astrit Kalaja | Anëtar |
| Elona Toro | Anëtare |
| Kleanth Zeka | Anëtar zëvendësues |
| Rilinda Selimi | Anëtare, relatore |

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **zj. Mimoza Arbi**, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës **28.12.2021**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDAT PËR GJYQATAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: z. Albert Demirneli

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së z. Albert Demirneli, në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, datë 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e relatores së Këshillit, **znj. Rilinda Selimi**, mendimin e paraqitur nga **Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I. Rrethanat e çështjes**

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 19, datë 26.11.2021 ka vendosur “Lejimin e kandidimit të kandidatit Albert Demirneli, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, datë 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021”, vakancë e parakohshme, krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të përfundimit të mandatit, si pasojë e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Fatmir Hoxha.
2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, anëtarja e Këshillit, znj. Rilinda Selimi, në cilësinë e relatorit të vendit vakant të cituar më lart, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.
3. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati Albert Demirneli në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, anëtarja e Këshillit relatore e vendit vakant në të cilën ky kandidat ka paraqitur kandidaturën e tij, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të këtij kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.
4. Këshilli, pasi shqyrtoi procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga secili relator dhe plotësinë e dokumentacionin të paraqitur për vlerësim nga secili kandidat, dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatëve, me vendimin e datës 03.12.2021 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendet vakante, si më poshtë:

a) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të përfundimit të mandatit, si pasojë e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Fatmir Hoxha, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, datë 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021.

5. Këshilli ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, për katër vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të treguara në pikën 8 të këtij Vendimi.

6. Intervista mbi motivimin e kandidimit me kandidatin e lejuar, Z. Albert Demirneli, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, datë 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021, u zhvillua në datën 10.12.2021.

7. Lidhur me nivelin e zotërimit të gjuhës së huaj nga kandidati e lejuar, Z. Albert Demirneli, është mbajtur/shprehur qëndrimi që nuk dëshiron të intervistohet në gjuhë të huaj.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

8. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati Albert Demirneli në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera të kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Albert Demirneli për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

a) në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës;

b) në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuara, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;

c) në detajimin e mëtejshëm të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimit më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 1 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

Vjetërsia në profesion

9. Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi “Vjetërsia në profesion”. Ndërkohë që, sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi që kandidati të ketë së paku 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.

10. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë kohëzgjatjen për më shumë se 15 vjet të këtyre fushave të përvojës profesionale të secilit kandidat, në maksimum deri në 4 pikë, sikurse orientohet në tabelën e përshkallëzuar të pikëzimit të vjetërsisë në profesion, të treguar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

11. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Albert Demireli, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- a) *31 janar 2008 e në vazhdim Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- b) *01 qershor 2002 – 31 janar 2008 zv/prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- c) *07 janar 2002-31 maj 2002 zv/prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë*
- d) *31 korrik 1994 – 7 janar 2002 prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mirditë*
- e) *Korrik 1993- korrik 1994 hetues Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër*
- f) *Maj 1992 – qershor 1993 zv/kryetar i Hetuesisë Dibër*
- g) *16 tetor 1991 – maj 1992 kryetar i Hetuesisë Dibër*
- h) *7 gusht 1987- 18 tetor 1991 hetues, Hetuesia e Rrethit Kukës*

12. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, rezulton se në rastet e veprimtarive sipas shkronjave “a” deri “d” kandidati Albert Demireli ka ushtruar veprimtari profesionale në fushat e përcaktuara sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Në momentin e përpilimit të relacionit të vlerësimit (dhjetor 2021), ky kandidat ka gjithsej 32 vjet e 6 muaj vjetërsi në profesion dhe përvojë në fushën e të drejtës penale, ndërsa në momentin e kandidimit, ka 27 vjet e 4 muaj vjetërsi në profesion dhe përvojë pune si prokuror, funksion i përcaktuar edhe nga neni 125 i Kushtetutës.

13. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “vjetërsia në profesion”, nisur nga ushtrimi i veprimtarive profesionale në një kohëzgjatje prej 27 vjet dhe 4 muaj Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin Albert Demireli me **4 (katër) Pikë**.

Historiku Arsimor

14. Në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

15. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

16. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Albert Demirneli ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1987 si jurist, në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

17. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe nga vetëdeklarimi i bërë nga kandidati Albert Demirneli, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 7.2.

18. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare 7.2 e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike të Universitetit të Tiranës, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin Albert Demirneli me **“0” (zero) Pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

19. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi kualifikimet pasuniversitare. Ky kriter vlerëson llojin dhe nivelin e angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të madh në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrimeve profesionale të tilla si, pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

20. Referuar kritereve ligjore të vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, që gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar në Shtojcën nr. 1 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kualifikimeve pasuniversitare, si një nga indikatorët me të cilët vlerësohet niveli profesional i kandidatëve, u janë caktuar në total 8 pikë.

21. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

22. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton që kandidati të ketë kualifikime pasuniversitare. Rezulton se kandidati Albert Demirneli ka përfutur titullin “Avokat” (Nr. 3787 liçence, 30.03.2008), i cili nuk përfshihet në kategorinë e kualifikimeve pasuniversitare.

23. Sa më lart, për kriterin e vlerësimit “*kualifikime pasuniversitare*”, kandidati Albert Demirneli vlerësohet me **0 (zero) Pikë**.

24. Për treguesin e vlerësimit “*Trajnimet e tjera*”, vlerësohen veçanërisht trajnime me një kohëzgjatje minimale 2 javore, ku mbahen pasur parasysh edhe numri, llojet, tematikat dhe kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, institucionet trajnuese, si dhe nëse trajnimet janë shoqëruar me një certifikatë vlerësimi, për kandidatin/ten Këshilli mund të caktojë deri në 2 pikë.

25. Lidhur me këtë tregues kandidati Albert Demirneli ka deklaruar se në periudhën: 1996, 1999, 2000, 2001, 2004, 2005, 2006, 2017, 2018, 2019, 2020 ka kryer këto trajnime:

- Aktiviteti trajnues me temë: “Provat dhe teknikat e hetimit”, zhvilluar më datë 20-21 janar 2020 nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me EURALIUS;
- Aktiviteti trajnues me temë: “Gjykimi i shkurtuar dhe gjykimi i drejtpërdrejtë, si gjykime të posaçme. Veçoritë e gjykimit të shkurtuar dhe problemet e praktikës gjyqësore. Ndryshimet e bëra me ligjin nr. 35/2017 dhe nevoja për kuptimin e drejtë të tyre. Veçoritë e rastit të dytë të gjykimit të drejtpërdrejtë: praktika gjyqësore. Urdhri penal i dënimit dhe gjykimi me marrëveshje - risi të KPP-së; Marrëveshja për pranimin e fajësisë, përmbajtja dhe rastet e refuzimit të marrëveshjes”, zhvilluar më datë 1-2 korrik 2019 nga Shkolla e Magjistraturës (prezent vetëm ditën e dytë datë 2 korrik);
- Aktiviteti trajnues me temë: “Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave”, zhvilluar më datë 23-24 prill 2019

- nga Shkolla e Magjistraturës (prezent vetëm ditën e parë datë 23 prill);
- Aktiviteti trajnues me temë: “Roli i gjykatës dhe institucioneve të mekanizmit referues në zbatim të ligjit nr. 18/2017, “Mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, zhvilluar më datë 4-5 shkurt 2018 nga Shkolla e Magjistraturës (prezent sesionin e dytë të ditës së parë dhe ditën e dytë në të dy sesionet);
 - Aktiviteti trajnues me temë: “Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike. Kuadri ligjor lidhur me njoftimet me fokus në nenet 133 - 142/a të Kodit të Procedurës Penale; Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë; Njoftimi i të pandehurit person juridik; Njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet”, zhvilluar më datë 12 janar 2018 nga Shkolla e Magjistraturës (prezent vetëm sesionin e parë);
 - Aktiviteti trajnues me temë: “Veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Hetimet paralele financiare kriminale për identifikimin dhe ngrirjen e produkteve ose pasurisë që rrjedh nga kjo veprimtari; Efektet në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave nëpërmjet dënimit të autorëve të këtyre veprave dhe konfiskimit të pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale”, zhvilluar më datë 10-11 dhjetor 2017 nga Shkolla e Magjistraturës;
 - Aktiviteti trajnues me temë: “Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale”, zhvilluar më datë 7 korrik 2017 nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me OPDAT;
 - Aktiviteti trajnues me temë: “Krimi ekonomik, Hetimi dhe nxjerrja e pasurisë kriminale”, zhvilluar më datë 29-30 qershor 2017 nga Shkolla e Magjistraturës;
 - 24 shkurt 2006 - 25 shkurt 2006, Trajnim me temë “Impakti Operacional i reformës aktuale të drejtësisë penale”, Shkolla e Magjistraturës. (Kurset vazhduese pranë Shkollës së Magjistraturës)
 - 24 shkurt 2005 - 25 shkurt 2005, Seminar me temë “Strategjitë për ratifikimin e protokollit të dytë shtojcë të Konventës Evropiane për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale”, Organizuar nga Këshilli i Evropës.
 - 23 shtator 2004- Trajnim me temë “Përmirësimi i sistemit të burgjeve”, Programi CARDS/TWINNING
 - 1 qershor 2004 - 2 qershor 2004, Trajnim me temë “Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve”, Shkolla e Magjistraturës (Kurset vazhduese pranë Shkollës së Magjistraturës)
 - 26 shkurt 2001 - 28 shkurt 2001, Seminar me temë “Parandalimi dhe lufta ndaj trafikut të qenieve njerëzore”, në veçanti të grave dhe minoreneve” Organizuar nga Qeveria Italiane/ OPDAT Romë, Itali
 - 12 mars 2001 - 14 mars 2001, Seminar me temë “Avokatia gjyqësore për Prokurorinë Penale” Ambasada Amerikane, Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës / OPDAT Tiranë, Shqipëri.
 - 13 dhjetor 2000 - 15 dhjetor 2000 Seminar me temë “Trajtimi i qenieve njerëzore, eksperiencia italiane dhe instrumentet ndërkombëtare”, Organizuar nga Qeveria Italiane/ OPDAT, Tiranë, Shqipëri.
 - 14 nëntor 2000 - 21 nëntor 2000, Kurs kualifikimi për “Krimin e Organizuar”, Prokuroria Antimafia Italiane Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor: Romë, Itali.

- 17 korrik 1999 - 23 korrik 1999, Kurse kualifikimi me temë “Kodi i Ri i Procedurës Penale”, Shoqata ABA / CEELI , Varshavë, Poloni.
- 16 shtator 1996 - 30 shtator 1996, Kurs kualifikimi me temë “Kodi i Ri i Procedurës Penale”, Këshilli i Evropës, Romë, Itali
- 1 prill 1996-4 prill 1996, Seminar mbi krimin ekonomik dhe të organizuar, Organizuar nga Qendra për Dokumentacionin Ndërkombëtar (CIDOEC), Qeveria Britanike dhe Fondacioni "SOROS", Tiranë, Shqipëri.

26. Lidhur me trajnimet e sipër përshkruara dhe të deklaruara, kandidati ka paraqitur këto certifikata:

1. Vërtetim nr. 959 prot, datë 07.12.2021 lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, Sektori i Formimit Vazhdues me anë të të cilit Vërtetohet se z. Albert Demimeli ka qenë pjesëmarrës në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, për periudhën Janar 2017 e në vazhdim.
2. Certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin me temë “Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe OPDAT, Tiranë me 07.07.2017”.
3. Certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin me temë “Veprat Penale në Fushën e Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, Tiranë me 11-12 dhjetor 2017”
4. Certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin me temë “Introductory training module on cybercrime, electronic evidence and online crime proceeds” organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, Unioni Evropian dhe Këshilli i Evropës, Tiranë me 30-31 Maj/ 18-19 qershor 2018”
5. Certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin me temë “Provat e Marra në kundërshtim me ligjin dhe kuptimi i nocionit të papërdorshmërisë. Kriteret e dallimit nga pavlefshmëria e akteve në përjasje me doktrinën dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, Tiranë me 01- 02 mars 2012”.
6. Certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin me temë “Impakti operacional i reformës aktuale të drejtësisë penale”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, Pameca dhe OPDAT, Tiranë me 24-25 Shkurt 2006”.
7. Certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin me temë “Ndryshimet e Kodit Penal (me ligjin 23/2012 dhe ligjin 144/2013) Veprat kundër personit, krimet kundër jetës. Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, Pameca dhe OPDAT, Tiranë me 15 Shkurt 2014”.
8. Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës nr. 440 prot, datë 14.10.2016 që ka marrë pjesë në trajnime vazhduese datë 12 prill 2014 dhe datë 14 shkurt 2014”.

27. Sa më sipër, sipas dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Albert Demimeli vërtetohet se ka ndjekur 8 veprimtari trajnimi afatshkurtra për periudhën 2014 –2021, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës në Tiranë si dhe deklaroi se ka kryer, duke filluar nga

viti 2016, trajnime të tjera afatshkurtra brenda vendit si dhe jashtë vendit në Itali, Poloni. Tematika e këtyre veprimtarive lidhet me: *“krimin ekonomik dhe të organizuar, Kodi i Ri i Procedurës Penale, Provat dhe teknikat e hetimit, Gjykimi i shkurtuar dhe gjykimi i drejtpërdrejtë, si gjykime të posaçme ... Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëshmërbliimi i viktimave Roli i gjykatës dhe institucioneve të mekanizmit referues në zbatim të ligjit nr. 18/2017, “Mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike. Veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Hetimet paralele financiare kriminale për identifikimin dhe ngrirjen e produkteve ose pasurisë që rrjedh nga kjo veprimtari; Efektet në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave nëpërmjet dënimit të autorëve të këtyre veprave dhe konfiskimit të pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale” Krimi ekonomik, Hetimi dhe nxjerrja e pasurisë kriminale Impakti Operacional i reformës aktuale të drejtësisë penale Strategjitë për ratifikimin e protokollit të dytë shtojcë të Konventës Europiane për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale Përmirësimi i sistemit të burgjeve Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve Parandalimi dhe lufta ndaj trafikut të qenieve njerëzore”, në veçanti të grave dhe minoreneve Avokatia gjyqësore për Prokurorinë Penale Trajtimi i qenieve njerëzore, eksperiencia italiane dhe instrumentet ndërkombëtare.” etj.*

28. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese afatshkurtra, të ndjekura nga kandidati Albert Demirneli në fushën e drejtësisë penale, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **1,5 (një presje pesë) Pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

29. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

30. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

31. Në vlerësimin dhe pikëzimin e shkallës së zotërimit të gjuhëve të huaja sipas këtij kriteri, Këshilli mban parasysh njohjen nga kandidatët/et të pesë gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht), të treguara në nenet 76 pika 4 dhe 78 pika 3 të ligjit nr. 80/2015. Në mënyrë të veçantë, Këshilli do të konsiderojë në vlerësim shkallën e zotërimit të gjuhëve anglisht e frëngjisht. Vlerësimi i nivelit të njohjes së gjuhës së huaj orientohet mbi gjuhën apo njërën nga gjuhët që vetë kandidati deklaroi paraprakisht se preferon të testohet gjatë zhvillimit të intervistës. Nga ana tjetër, përkundrejt mospërfitimit të pikëve përkatëse për këtë

kriter vlerësimi, kandidati/tja mund të zgjedhë, sipas çmimit të tij/saj, që të mos i nënshtrohet vlerësimit të Këshillit për gjuhët e huaja gjatë intervistës.

32. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Albert Demirmeli, ka vetëdeklaruar se njeh në nivelin A1 gjuhën angleze. Në dosje nuk është depozituar dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj.

33. Gjithashtu, gjatë intervistës së zhvilluar me Këshillin në datën 10.12.2021, kandidati ka deklaruar se nuk dëshiron të intervistohet në gjuhë të huaj.

34. Për sa më lart, duke qenë se për kandidatin nuk provohet njohja e gjuhës së huaj, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin Albert Demirmeli për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **0 (zero) Pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

35. Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

36. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh sipas vendimit normativ nr. 5, datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

37. Në rastin e kandidatit Albert Demirmeli, Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale si Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë..

38. Për sa i përket vlerësimit sasior, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, Këshilli shqyrtoi edhe të dhënat e dërguara me shkresën nr. 17405 prot datë 24.12.2021 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Sipas të dhënave zyrtare të përcjella nga ky institucion, në përputhje me natyrën e veprimtarisë dhe të detyrës që ka ushtruar, për periudhën 08.10.2017 deri në 08.10.2021, rezulton se: “Gjatë vitit 2017, rezulton se prokurori Albert Demirneli ka përfunduar me vendimmarrje gjithsej 180 procedime penale, nga të cilat 29 çështje të pushuara, 40 çështje të dërguara për gjykim, 84 çështje të pezulluara për moszbulim autori. Gjithashtu, gjatë të njëjtit vit ka marrë edhe 198 vendime për mosfillimin e procedimit penal. Gjatë vitit 2018, rezulton se prokurori Albert Demirneli, ka përfunduar me vendimmarrje gjithsej 139 procedime penale, nga të cilat 11 çështje të pushuara, 37 çështje të dërguara për gjykim, 67 çështje të pezulluara për moszbulim autori. Gjithashtu gjatë të njëjtit vit ka marrë edhe 121 vendime për mosfillimin e procedimit penal. Gjatë vitit 2019, rezulton se prokurori Albert Demirneli ka përfunduar me vendimmarrje gjithsej 175 procedime penale, nga të cilat 22 çështje të pushuara, 56 çështje të dërguara për gjykim, 84 çështje të pezulluara për moszbulim autori. Gjithashtu gjatë të njëjtit vit ka marrë edhe 168 vendime për mosfillimin e procedimit penal. Gjatë vitit 2020, rezulton se prokurori Albert Demirneli, ka përfunduar me vendimmarrje gjithsej 158 procedime penale, nga të cilat 25 çështje të pushuara, 42 çështje të dërguara për gjykim, 91 çështje të pezulluara për moszbulim autori. Gjithashtu gjatë të njëjtit vit ka marrë edhe 179 vendime për mosfillimin e procedimit penal. Gjatë vitit 2021, rezulton se prokurori Albert Demirneli, ka përfunduar me vendimmarrje gjithsej 304 procedime penale, nga të cilat 39 çështje të pushuara, 87 çështje të dërguara për gjykim, 77 çështje të pezulluara për moszbulim autori, 1 çështje e dërguar për kompetencë. Gjithashtu gjatë të njëjtit vit ka marrë edhe 151 vendime për mosfillimin e procedimit penal. Aktualisht ka në hetim sipas zyrës së statistikave 100 procedime penale. Nga ana e prokurorit Albert Demirneli, përgjatë këtyre viteve, është mbajtur një qëndrim i drejtë dhe objektiv, në respektim të plotë të ruajtjes së integritetit të figurës së magjistratit, si në fazën e hetimeve paraprake edhe në fazën e përfaqësimit të çështjeve në gjykatë. Karakterizohet për disiplinë në punë dhe korrektësi maksimale në raport me palët në proces. Sikurse rezulton edhe nga statistikat, ngarkesa në punë e prokurorit ka qenë tepër e lartë, por është përballuar më së miri prej tij për çdo vit kalendarik.

39. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës si Prokuror, Këshilli vlerëson se në aspektin sasior kandidati Albert Demirneli ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin Albert Demirneli për këtë tregues vlerësimi me **5 (pesë) Pikë**.

40. Për sa i përket vlerësimit cilësor, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati Albert Demirneli, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionalë dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetues nga organet e emërtesës.

41. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, në datën 09.12.2021, kandidati Albert Demirneli ka njoftuar Këshillin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka përzgjedhur pesë dokumente profesionale si më poshtë:

- Vendim mosfillimi të procedimit penal, nr. 3229/2020
- Vendim pushimi të procedimit penal nr. 3098/2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për procedimin penal nr. 3229/2020.
- Konkluzione përfundimtare të çështjes, që i përket procedimit penal nr. 9376 si dhe
- Vendim Pezullimi të hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 6637/2020.

42. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se kandidati Albert Demirneli nuk ka përgatitur në cilësinë e autorit apo bashkëautorit publikime profesionale, kërkime shkencore, si dhe artikuj të tjerë profesional, brenda apo jashtë vendit.

43. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati Albert Demirneli, dhe në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë tregues vlerësimi, Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 1 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

44. Dokumentet profesionale të shqyrtuara rezultojnë akte procedurale të përgatitura nga kandidati në faza të ndryshme të hetimit penal dhe dërgimit të çështjes për gjykim. Nga përmbajtja e tyre rezultojnë një sërë veprimesh hetimore të kryera nga kandidati si përfaqësues i organit të akuzës dhe për procedime penale për vepra të ndryshme.

45. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është *“Origjinaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit”*. Nisur nga profili profesional i kandidatit Albert Demirneli dhe përmbajtja e dokumenteve të analizuara, të përgatitura në kuadër të hetimit penal, evidentimit të dinamikës së ngjarjes dhe veprimeve hetimore, Këshilli, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin *“Origjinaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit”*, vjen në përfundimin se kandidati Albert Demirneli vlerësohet me **4,444 (katër presje katërqind e dyzet e katër) Pikë**.

46. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “*Aftësitë analitike*”, Këshilli vëren se pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara tregojnë se kandidati Albert Demirneli tregon zotërimin e aftësive shumë të mira në analizimin e të dhënave dhe informacioneve si dhe për të identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore, parimet dhe institutet e së drejtës penale dhe procedurale penale, sipas natyrës dhe qëllimit të vetë këtyre punimeve.

47. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë analitike*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Albert Demirneli vlerësohet me **4,222 (katër presje dyqind e njëzet e dy) Pikë**.

48. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli si shqyrtoi pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidati Albert Demirneli, vëren se këto akte procedurale penale përmbajnë të dhënat nga hetimet e kryera nga kandidati për procedime penale konkrete, veprimet hetimore të kryera dhe rezultatet e arritura, duke evidentuar dispozitat e së drejtës penale dhe procedurale penale të zbatueshme për secilin rast.

49. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Albert Demirneli vlerësohet me **2,666 (dy presje gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Pikë**.

50. Për treguesit “*Saktësia dhe precizoni*”, në thelb, u verifikua nëse në veprimtarinë profesionale të kandidatit është mbuluar me profesionalizëm çështja penale e përzgjedhur dhe nëse materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidati Albert Demirneli, Këshillit i rezulton se kandidati tregon nivel shumë të mirë të përcaktimit të çështjeve faktike dhe juridike të marra në analizë dhe zgjidhje dhe përdorim korrekt i terminologjisë juridike.

51. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Saktësia dhe precizoni*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Albert Demirneli vlerësohet me **3,777 (tre presje shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) Pikë**.

52. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli vëren se në këto punime janë të organizuara dhe të strukturuar, gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe profesionale. Këto punime janë të kuptueshme dhe të lexueshme dhe arrijnë qëllimin e synuar kundrejt individëve dhe subjekteve të cilat iu drejtohen.

53. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Qartësia*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Albert Demirneli vlerësohet me **3,555 (tre presje pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Pikë**.

54. Sa më lart, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Albert Demirneli vlerësohet në total me **19 (nëntëmbëdhjetë) Pikë**.

A. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

55. Në shkronjën “b” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe në sfera të tjera të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, përvojë të veçantë në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë, si edhe pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

56. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 12 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë ekspertizën në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizën në fusha të tjera të veçanta të së drejtës. Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 4 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

57. Në rastin e kandidatit Albert Demirneli, krahas jetëshkrimit, intervistës dhe motivimit për kandidim, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij si Prokuror, veçanërisht për një kohë të gjatë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, apo edhe nga kontributet e tjera profesionale në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë, pjesëmarrjet në veprimtari shkencore dhe veprimtari të tjera profesionale të lidhura me fushat e së drejtës.

Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës

58. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizës në fusha të tjera të veçanta të së drejtës*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumentet profesionale të paraqitura nga kandidati Albert Demirneli, Këshilli i rezulton se historiku dhe karriera e gjatë profesionale e këtij kandidati është e fokusuar në pjesën dërmuese të kohëzgjatjes dhe shtrirjes së saj në fushën e drejtësisë penale.

59. Këshilli vjen në këtë përfundim jo vetëm nga fakti që veprimtaria profesionale e këtij kandidati rezulton për mbi 27 vjet me ushtrimin e detyrës si prokuror, përvojë, e cila, e lidhur edhe me interesin e dëshmuar vetjak profesional, ka ndikuar në formimin profesional dhe specializimin e këtij kandidati në fushën e drejtësisë penale.

60. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës*” Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatit Albert Demirneli **7,333 (shtatë presje treqind e tridhjetë e tre) Pikë**.

Angazhime profesionale shtesë

61. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues, *angazhimeve profesionale shtesë*, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit Albert Demirneli rezulton që kandidati deklaroi disa angazhime shtesë profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij si prokuror duke qenë pjesëmarrës në disa tryeza të përbashkëta për çështje të lidhura me legjislacionin penal dhe procedural penal.

62. Prandaj, në vlerësim të profilit dhe karrierës profesionale si dhe, duke konsideruar shpjegimet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës për angazhimet e tij shtesë profesionale përmes dhënies së mendimeve si Prokuror mbi ndryshimet e legjislacionit në fushën e drejtësisë penale, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të “*angazhimeve profesionale shtesë*”, t’i caktojë kandidatit Albert Demirneli **1,222 (një presje dyqind e njëzet e dy) Pikë**.

Meritat Morale

63. Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për “*integritetin etik e moral*”. Po kështu, në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter “*Rezultatet e vlerësimit të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka*”, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përcaktohen si kriter vlerësimi edhe “*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*” dhe “*cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi*”. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriter vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

64. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 30 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 18 pikë *integritetin etik dhe moral*, deri në 10 pikë *reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve* dhe deri në 2 pikë *angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysht rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të KED dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

65. Në rastin e kandidatit Albert Demirneli, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

Integritetin etik e moral

66. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidati Albert Demirneli në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon angazhimin e duhur në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje dhe respekt në komunikim e bisedë, duke dëgjuar dhe iu përgjigjur me kujdesin e duhur pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

67. Në lidhje me vlerësimin e punës, pranë Këshillit është administruar dokumentacioni i depozituar nga kandidati lidhur me vlerësimet e punës “Shumë Mirë”, të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 si dhe Vendimi nr. 155, datë 08.07.2020 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për miratimin e raportit për analizën e aftësive profesionale të Prokurorit Albert Demirneli, së bashku me raportin e vlerësimit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë bën me dije se ndaj kandidatit Albert Demirneli, është dhënë një masë disiplinore “Vërejtje”, me urdhrin nr. 213, datë 19.12.2006 të Prokurorit të Përgjithshëm, masë e cila është shuar.

68. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Këshillit nuk i rezulton që kandidati Albert Demirneli, me sjelljen dhe veprimtarinë e tij në jetën profesionale dhe personale, të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të magjistratit.

69. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*integritetit etik e moral*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatit Albert Demirneli **17,333 (shtatëmbëdhjetë presje treqind e tridhjetë e tre) Pikë**.

Reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

70. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidati Albert Demirneli në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon angazhim dhe përkushtim profesional në përmbushjen e detyrave të tij, me qëllim zbatimin e drejtë të ligjit, sipas kompetencave dhe përgjegjësi që i ngarkon ligji.

71. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*” Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatit Albert Demirneli **8 (tetë) Pikë**.

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

72. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se, kandidati Albert Demirneli, për shkak të funksionit si prokuror, ka kontribuar financiarisht gjatë periudhës së pandemisë COVID -19.

73. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatit Albert Demirneli **0,444 (zero presje katërqind e dyzet e katër) Pikë**.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

74. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kritere vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

- “a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- d) aftësitë e përfaqësimit publik.”

75. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

76. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 10 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 3 pikë *cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 4 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 2 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 1 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

77. Në rastin e kandidatit Albert Demirneli, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të këtij kandidati.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

78. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidatit Albert Demirneli lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, mbi sfidat kryesore me të cilat është përballur dhe duhet të përballë Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e përgjegjësve dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

79. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidati Albert Demirneli, bazuar në përvojën e tij profesionale si magjistrat evidentoi rolin dhe rëndësinë e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të vijimësisë së traditës së jurisprudencës kushtetuese, transparencës së vendimmarrjes në funksion të respektimit të lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.

80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*” nga kandidatët Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatit Albert Demireli **1,777 (një presje shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) Pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

81. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësisht në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Gjithashtu, në vlerësimin e kandidatëve për këtë komponent vlerësimi, Këshilli mban parasysh se ushtrimi i çdo detyre, funksioni dhe veprimtari profesionale, edhe kur formalisht nuk lidhet drejtpërdrejt me të drejtën/detyrimin për ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse, gjithsesi përmban elementë që tregojnë aftësi të provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

82. Në rastin e kandidatit Albert Demireli, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

83. Këshilli vëren se kandidati Albert Demireli, në karrierën e tij profesionale, ka ushtruar funksionin e Prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë prej janarit të vitit 2008 e në vazhdim, siç pasqyrohet në pikën 12 në këtë vendim. Nga jetëshkrimi dhe të dhënat zyrtare rezulton se në ushtrimin e veprimtarisë së tij profesionale edhe si Zv/drejtues pranë Prokurorisë, ky kandidat ka ushtruar përgjegjësi të bashkërendimit të punëve në institucion.

84. Nga ana tjetër, nisur nga veprimtaria profesionale e larmishme si Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Këshilli vëren se kandidati ka dëshmuar aftësi të lartë vendimmarrëse për ushtrimin e detyrës, të cilat së bashku me profesionalizimin kanë rëndësi thelbësore për ushtrimin e suksesshëm të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

85. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*”, Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatit Albert Demireli **3,888 (tre presje tetëqind e tetëdhjetë e tetë) Pikë**.

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

86. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me kolegët dhe palët, sikurse edhe në përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

87. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Këshilli vëren se kandidati Albert Demireli zotëron aftësi shumë të mira për të komunikuar me seriozitet, për të dëgjuar me respekt dhe për t'u përgjigjur me qartësi e thjeshtësi, në lidhje me çështje dhe problematika që vlerëson të trajtohen dhe që ngrihen nga të tjerët.

88. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*”, Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidatit Albert Demireli **2 (dy) Pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale

89. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, për vetë natyrën e këtij funksioni, mënyrës së funksionimit dhe kolegialitetit të kërkuar në veprimtarinë e vendimmarrjen kësaj Gjykate, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë i përfshirë në punën në grup, me gjyqtarët e tjerë, këshilltarët dhe anëtarët e stafit të Gjykatës. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

90. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Këshilli vëren se kandidati Albert Demireli zotëron aftësitë e nevojshme për të punuar në grup. Përvoja e gjatë profesionale i kanë mundësuar këtij kandidati shprehje dhe të dhënat e duhura për punën në grup, në çështje e situata të ndryshme. Zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në vetë mënyrën e parashtrimit me shkrim të çështjeve në platformën e paraqitur, si edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Këshillin gjatë intervistës.

91. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale*”, Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidatit Albert Demireli **1 (një) Pikë**.

92. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendet vakante në të cilat ka kandiduar, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidati Albert Demireli vlerësohet në total me **72,5 (shtatëdhjetë e dy presje pesë) Pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatit Albert Demirneli, me 72,5 (shtatëdhjetë e dy presje pesë) Pikë në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, datë 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Albert Demirneli.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ANËTARE


Elsa TOSKA

Zv/KRYETARE

Marsida XHAFERLLARI

KRYETAR

Ervin PUPE

ANËTAR

Adnan XHOLI

ANËTAR

Astrit KALAJA

ANËTARE

Elona TORO

ANËTAR ZËVENDËSUES

Kleanth ZEKA

ANËTARE

Rilinda SELIMI